



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1115 /2 prot

Datë 19.05.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK**  
**ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Blinishta” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-65383-04-07-2023, me objekt: “Loti I III-të:”Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje në segmentin: "Ura e Mesit - Prekal - Kir - Breg Lumi - Nderlytaj", me fond limit 4,659,035.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Alb Konstruksion” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** “Blinishta” SHPK  
*Fshati Omaraj, Objekt 1 katësh, Zona Kadastrale 2827, Nr. Pasurie 87/9, Volumi 53, faqe 45, Malësi e Madhe*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër  
*Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër*

**Subjekte të Interesuar:** “Alb-Konstruksion” SHPK  
*Postribe Shkoder MES, Rruga Nacionale MesShkoder, godine 1-kateshe, nr pasurie 1/1, zona kadastrale 1545*

Në datën 18.05.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3112 dhe me nr. 1115/2023 prot., datë 18.05.2023 e operatorit ekonomik “Blinishta” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Blinishta” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alb-Konstruksion” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Blinishta” SHPK.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues “Blinishta” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

*“-Shtojca nr.9 Formulari Permbledhësi Vetdeklarimit nuk ka të plotësuar pikën 6, të shkronjes B, Deklarata Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” -Bilancet e vitit 2020-2021-2022 nuk janë të certifikuara nga Dega e Tatim Taksave -Nuk plotësoni kriterin për shërbime të ngjashme -Kontrata me objekt: Hapje e rruges Kalce”” është nënshkruar si bashkim operatorësh ekonomikë ndërsa formulari i vlerësimit është leshuar për vetëm njërin nga operatorët ekonomikë. Nuk është saktësuar përqindja e pjesëmarrjes dhe zërat konkretë që kanë marrë pjesë për të realizojnë. -Kontrata me objekt: Riparim rruga Kurte-Rrjoll është nënshkruar si bashkim operatorësh ekonomikë por nuk kanë të percaktuar përqindja e pjesëmarrjes dhe zërat konkretë që kanë marrë pjesë për të realizojnë”*

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues “Blinishta” SHPK ngre pretendime mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alb-Konstruksion” për mosplotësimin e kriterëve si më poshtë:

*Nuk plotëson kriterin e makinerive të kerkuara dhe të deklaruara në shtojcën 9 “Formulari Permbledhës i vetëdeklarimit”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 19.05.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**